



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1026_09_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 03.10.2013.

në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin J. A., (shifra e konsumatorit DGL – 9023759) nga Gjilani ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1026_09_13 i datës 18.09.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim të njehsorit elektrik me datë 05.03.2009 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik numër 43806105 me gjendje: TL= 00558 kW (tarifa e lartë) dhe TU= 03596 kW (tarifa e ulët), si dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEK me datë 16.03.2009 ka ngarkuar konsumatorin me faturën për shërbime/lidhje e re në vlerë **116.00€**, duke i hapur shifrën DGL- 9023759, si dhe me datë 01.04.2009 i ka dërguar konsumatorit faturën për periudhën mars 2009 për **4,144 kW** apo e shprehur në vlerë financiare **240.15 €**.

Pas kësaj fature të energjisë elektrike konsumatori me datë 15.11.2012 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator duke kundërshtuar faturën e muajit mars 2009.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 26.11.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij duke theksuar se pagesa që është bërë në emër të shifrës tjetër ka qenë e arsyeshme pasi keni banuar aty, ndërsa vendosja e njehsorit tuaj në shtëpi të tjetërkujt është i paregjistruar dhe ajo rezulton me kilovat të shpenzuar.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 18.09.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të korrigjoj faturën 03090DGL-9023759 e datës 01.04.2009 në vlerë (-39.56€) duke bërë shpërndarjen e kW për periudhën gjashtë mujore (10/2008 deri më 03/2009).



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 03.10.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se nuk ka asnjë provë bindëse me të cilën do të vërtetohej gjendja faktike përveç deklaratës gojore. Në ankesë theksohet se konsumatori i detyrohet KEDS-it që në shifrën DGL – 9023579 e me numër njehsori 43806105 t'i paguaj të gjithë kilovatët e shpenzuar ndërsa sa i përket pagesave në njehsorin e huaj konsumatorii nuk ka prezantuar se ka bërë ankesë se banon në atë shtëpi dhe se konsumatori legal i KEDS-it në shifrën DGL – 9729 është Lecaj Ruzhdi Begu.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pretendimet e KKDFE-së se nuk ka asnjë provë bindëse me të cilën do të vërtetohej gjendja faktike përveç deklaratës gojore nuk qëndrojnë, pasi që gjatë shqyrtimit të lëndës janë prezantuar dokumente të ndryshme, si procesverbali i regjistrimit të njehsorit elektrik nr. 025548 i datës 05.03.2009 me të cilën vërehet se sipas gjendjes së regjistruar të shpenzimit njehsori ka qenë duke regjistruar energji elektrike edhe më herët dhe se gjatë regjistrimit të njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar se në procesverbal se mungon pronari i objektit. Po ashtu duhet theksuar se Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas procesverbalit të KEK-ut nr. 025548 të datës 05.03.2013 konsumatori në asnjë rast nuk ka bërë kërkesë zyrtare në KEK për kyçjen e njehsorit në rrjetin elektrik e që është në kundërshtim me nenin 8 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji po ashtu shfrytëzimi i energjisë elektrike pa lejen e furnizuesit përkatësisht pa nënshkrimin e kontratës për kyçje dhe furnizim me energji elektrike paraqet shkelje të nenit 29 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se konsumatori detyrohet që në shifrën DGL – 9023579 e me njehsorin nr. 43806105 t'i paguaj të gjithë shpenzimin e shpenzuar duhet theksuar se gjatë shqyrtimit të lëndës së konsumatorit Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën një vjeçare 01/2010 deri më 12/2010 është 638 kWh/muaj, andaj duke pasur parasysh mesataren e shpenzimeve, mos përcaktimin e saktë të kohës kur konsumatori e ka vendosur njehsorin elektrik, procesverbalin mbi pranimin e instalimit elektrik nr. 025548 të datës 05.03.2009, shpenzimet për periudhën e njëjtë kohore në vitet pasuese, si dhe faturimin e shpenzimit të grumbulluar me rastin e regjistrimit të njehsorit elektrik nr. 43806105, konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korigjimi i faturës së energjisë së muajit mars 2009 duke bërë shpërndarjen e shpenzimit për periudhën gjashtë mujore, prej periudhës 10/2008 deri më 03/2009 në vlerë prej - 39.56€. Pra, sipas kësaj shpenzimi i energjisë elektrike i regjistruar në njehsorin elektrik nr. 43806105 duhet të kalkulohej dhe të paguhen, por pasi që vërehet se është grumbullim shpenzimi atëherë duhet t'i bëhet shpërndarja e shpenzimit për periudhën e lartcekur. Bordi i ZRRE-së thekson se sipas Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe procedurës së leximit dhe faturimit, punëtorët e autorizuar të KEK-ut e kanë obligim ligjor t'i vizitojnë çdo muaj konsumatorët për të bërë leximin e pikave matëse, si dhe të shtegu i leximit të këtij konsumatori të kësaj shifre është bërë leximi i pikave matëse, andaj edhe është dashur të vërehet kyçja e këtij konsumatori, të merren masa sipas rregullës dhe procedurës, por që shpenzimi i energjisë elektrike në njehsor mos të lejohet të grumbullohet dhe pastaj të faturohet si shpenzimi mujor.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1026_09_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të



të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar